

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Protestat në Nju Jork, Rama: S'më ndalin vezët dhe balta, flamuri shqiptar do vendoset majë Europës së Bashkuar
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/protestat-ne-nju-jork-rama-sme-ndalin-vezet-dhe-balta-flamuri-shqiptar--i588366
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:04:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7bece8571dee5ef47372d6aac05b37cf7e7b2a30b00130fd5c9da41782590ced
TEKSTI	be75f4eba35421c564c54bed78714052cb1709282b8ea66da10a9777f05edfca
PAMJA	51d16b20ed7c624776bd1d3427f5ef12bb0ec46740a524f976f51fbbbeab7f78

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b9d2b9a86f05ceaf3fd417fe34e9dc4175b1662e167aa28097c0286c090ff5c7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b9d2b9a86f05ceaf3fd417fe34e9dc4175b1662e167aa28097c0286c090ff5c7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie FOTO/ E akuzoi per perdhunim kur ishte 13 vjece. gruaja terheq akuzat ndaj Jay-Z: "Nuk e kam takuar kurre" Mickoski ne mbremjen gala te Keshillit Shqiptaro-Amerik fundit

Protestat në Nju Jork, Rama: S'më ndalin vezët dhe balta, flamuri shqiptar do vendoset majë Europës së Bashkuar



25 Shtator 2026, 17:10Politika TEMA



Kryeministri Edi Rama ka reaguar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke iu drejtuar kritikëve që protestuan me flamurin kombëtar në Nju Jork duke theksuar se ata "mbulohen me flamurin kombëtar dhe çarten rrugëve si pula histerike".

Ai shkruan në reagimin e tij "atë flamur e kam ngritur më lart se çka qenë kurrë ndonjëherë në sytë e botës".

Rama u është drejtuar gjithashtu atyre që, sipas tij, "kujtojnë se do më ndalin me baltë, vezë dhe jargë" në misionin e tij për ta çuar flamurin shqiptar "në majën e Europës së Bashkuar".

Kryeministri ka vlerësuar se "për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, kemi një sistem institucional që shfaq aftësi vetëpastrimi", duke e konsideruar këtë arritje si rezultat të drejtpërdrejtë të misionit të tij dhe të Partisë Socialiste.

Në vazhdim të reagimit, kryeministri ka komentuar edhe mbi akuzat e vazhdueshme për korrupsion, duke i quajtur "bomba çudibërëse" që amplifikohen "ditë e natë".

Sipas tij, "në një vend që është i mbytur në kënetën e korrupsionit, nuk ka luftë frontale e as rezultate konkrete kundër korrupsionit" – një realitet që, thekson ai, Shqipëria e ka jetuar deri kur qeveria e tij "e kthym rotën e drejtësisë nga barazia e të gjithëve para ligjit".

Rama ka nënvizuar se sot Shqipëria "nuk është më ai vend" dhe se Bashkimi Evropian e çmon gjithnjë e më shumë vendin për këtë luftë. Ai ka kritikuar ashpër "pulat histerike të katundit tonë" që, sipas tij, "kakarisin e hedhin vezë në ajër për llogari të gjelave tallagjarë të pazarit politik e mediatic".

Këtyre që mbulohen me flamurin kombëtar dhe çarten rrugëve si pula histerike, u them vetëm se atë flamur e kam ngritur më lart se çka qenë kurrë ndonjëherë në sytë e botës. Kurse atyre që kujtojnë se do më ndalin me baltë, vezë dhe jargë, në misionin tim për ta çuar flamurin tonë në majën e Europës së Bashkuar, u them se nëse për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, kemi një sistem institucional që shfaq aftësi vetëpastrimi, kjo është një arritje e madhe që nuk ka rënë nga qielli po ka ardhur pikërisht si një nga rezultatet e këtij misioni!

Dhe le ta dëgjojnë e ta mbajnë mirë vath në vesh meqë kujtojnë se mposhtem unë dot me "bombat çudibërëse" që amplifikojnë në kupë të qiellit ditë e natë

fjalën korrupsion:

Në një vend që është i mbytur në kënetën e korrupsionit, nuk ka luftë frontale e as rezultate konkrete kundër korrupsionit dhe atë vend e kemi jetuar ne, që të gjithë, deri kur unë me partinë time e kthyem rrotën e drejtësisë nga barazia e të gjithëve para ligjit!

Sot Shqipëria nuk është më ai vend e prandaj edhe Bashkimi European e çmon gjithnjë e më shumë Shqipërinë për këtë luftë, ndërkohë që pulat hysterike të katundit tonë kakarisin e hedhin vezë në ajër për llogari të gjelave tallagjarë të pazarit politik e mediatik, të cilët i gënjen mendja sa një vezë, se do të më ndalin mua me llogjet e pafundme për korrupsionin që po luftohet nga vetë sistemi që po ndërtojmë, apo me sharjet e mallkimet folklorike si të këtij sqepit bashkëngjitur, që e shkruan shqipen me këmbët e pulës.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Ky vend e tradhtoi Hashim Thaçin", Rama nga New York: SHBA nuk bëri më të mirën për George Washington-in e Kosovës](#)

16:43 Politika / 3 komente

["100 bashki dhe 12 qarqe", PD depoziton ligjin për ndarjen territoriale të vendit](#)

16:35 Politika / 1 koment

[Von der Leyen nis turneun në Ballkan - Presidentja e KE-së mbërrin të mërkurën për takime zyrtare](#)

16:05 Politika / 2 komente

[Hoxha nga Nju Jorku: Bashkëpunimi rajonal, domosdoshmëri për sigurinë dhe mirëqenien në Ballkanin Perëndimor](#)

14:51 Politika / 3 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.